



Бр. / Nr. 11 - 1339 / 1

02-02-2023

MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE TË RINJVE

shpall

THIRRJE PUBLIKE

mbi pjesëmarrjen e organizatave civile në grupin e punës në nivel teknik për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit për Garancinë Evropiane për Fëmijë (2026–2030)


1. Qëllimet e Thirrjes Publike

Qëllimi i kësaj Thirrjeje Publike është siguri i pjesëmarrjes së sektorit civil në procesin e përgatitjes së Planit Kombëtar të Veprimit për Garancinë Evropiane për Fëmijë, përmes përzgjedhjes së dy përfaqësuesve të organizatave civile, me përvojë dhe ekspertizë relevante në fushën e të drejtave dhe të mirëqenies së fëmijëve.

2. E DREJTA PËR PJESËMARRJE

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë organizatat civile, të cilat:

- janë të regjistruara në përputhje me Ligjin e Shoqatave dhe Fondacioneve;
- kanë të paktën tre vjet veprimtari aktive;
- kanë dëshmuar përvojë në një ose më shumë nga fushat e mëposhtme:
- të drejtat e fëmijëve;
- mbrojtja sociale;
- varfëria dhe përjashtimi social i fëmijëve;
- zhvillimi dhe arsimi në fëmijërinë e hershme;
- kujdesi shëndetësor dhe shëndeti mendor i fëmijëve;
- përfshirja e fëmijëve të grupeve të cënueshme (fëmijët me aftësi ndryshe, fëmijët romë, fëmijët e familjeve të varfra, etj.).



3. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Gjatë përzgjedhjes do të merren parasysh kriteret në vijim:

- rëndësia e mandatit dhe e aktiviteteve të organizatës;
- përvoja profesionale dhe ekspertiza e përfaqësuesit të propozuar;
- përvoja për pjesëmarrje në grupe të punës, në politika dhe/ose në analiza;
- njohuria mbi politikat kombëtare dhe evropiane që ndërlidhen me fëmijët;
- aftësia për kontribut aktiv dhe të vazhdueshëm në punën e Grupit të Punës.

4. KOHËZGJATJA E PJESËMARRJES

Përfaqësuesit e përzgjedhur:

- do të marrin pjesë në punën e Grupit të Punës në nivel teknik;
- do të kontribuojnë me mendime, propozime dhe analiza të ekspertëve;
- do të marrin pjesë në takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Grupit të Punës.

Pjesëmarrja zgjat për periudhën e përpilimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Garancinë Evropiane për Fëmijë (2026–2030).

5. DOKUMENTET E NEVOJSHME

Për regjistrim nevojitet të dorëzohen:

1. Fletëparaqitja e plotësuar (letër motivimi e shkurtër);



2. Biografia e shkurtër (CV) e përfaqësuesit të propozuar;
3. Përshkrimi i shkurtër i përvojës relevante të organizatës;
4. Aktvendimi i regjistrimit të organizatës (kopje).

6. MËNYRA DHE AFATI PËR PARASHTRIMIN E FLETËPARAQITJEVE

Fletëparaqitjet dorëzohen në arkivin e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve me shënimin:

“Thirrja Publike - Plani Kombëtar i Veprimit për Garancinë Evropiane për Fëmijë (2026–2030)”

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve është 5 ditë nga data e shpalljes së Thirrjes Publike në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve <https://www.mtsp.gov.mk/>.

7. PËRZGJEDHJA

Përzgjedhjen e përfaqësuesve do ta bëjë Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, në bazë të kriterëve të përcaktuara.